



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

Nr. 3427 prot.

Tiranë, më 07 . 05 .2019

**VENDIM**

**Nr. 29, datë 07.05.2019**

**PËR**

**PEZULLIMIN E ZHVILLIMIT TË SHORTIT TË MUAJIT MAJ, KORRIK DHE  
SHTATOR 2019**

Në mbështetje të Kushtetutës, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 9, pika 2 e Rregullores së veprimtarisë së Komisionit, miratuar me vendimin nr. 2, datë 19.07.2017, në mbledhjen e datës 07.05.2019, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit,

**VËREN:**

Aktualisht janë në procedura rivlerësimi 115 çështje nga viti 2018 dhe 72 çështje të cilat janë shpërndarë me procedurat e shortit gjatë periudhës janar –mars 2019.

Pjesë e këtyre çështjeve tashmë të shpërndara, janë edhe subjektet e rivlerësimit që janë kandidatë për Strukturën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), si dhe Gjykatën Kushtetuese. Procesi i rivlerësimit për këta të fundit është çështje me përparësi dhe duhet të përfundojë brenda një kohë sa më të afërt.

Zhvillimi i procedurave të rivlerësimit dhe kryerja e hetimit administrative të thelluar kërkon një kohë të konsiderueshme për t’u realizuar. Duke marrë parasysh këtë fakt, si dhe dinamikën përmes së cilës kalon një çështje, duke përfshirë kërkimin e informacionit, përpunimin dhe arsyetimin e gjetjeve, parashtrimin e tyre para trupit gjykues dhe vëzhguesit ndërkombëtar, Komisioni arsyeton se shpërndarja e çështjeve të reja do të shkaktonte ngarkesë, vonesë dhe zvarritje të procesit të rregullt për çështjet që tashmë janë shpërndarë me short dhe veçanërisht për çështjet me përparësi.

Respektimi i afateve ligjore të arsyeshme dhe kryerja e një hetimi administrativ të thelluar dhe të paanshëm janë parime mbi të cilat Komisioni bazon veprimtarinë e tij.

Komisioni vlerëson si të ligjshme dhe tepër të rëndësishme përfundimin e procedurave të rivlerësimit për këto çështje, si dhe të çështjeve për ngritjen e organeve të reja të drejtësisë.

Bazuar në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, zhvillimi i procedurave të shortit të radhës duhet të kryhet në datën 15 maj 2019, me anë të të cilit duhet të shpërndahen 36 çështje të reja midis komisionerëve.

Komisioni arsyeton se ndërkohë që janë ende në proces 187 çështje, midis të cilave edhe lista e prioritetëve, shpërndarja e çështjeve të reja do të rriste ngarkesën e punës së komisionerëve, dhe për pasojë do të cenonte cilësinë dhe efikasitetin në realizimin e hetimit dhe procedurave të rivlerësimit, duke zbehur rëndësinë që ka procesi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Pas administrimit të të gjithë informacionit dhe rrethanave të çështjes, në respektim të rëndësisë dhe seriozitetit të procesit të rivlerësimit, si dhe parimit të gjykimit brenda një afati ligjor të arsyeshëm, pasi dëgjoi edhe mendimet e komisionerëve, në mbledhjen e datës 7 maj 2019, ora 17:00, Komisioni, me unanimitet,

### **V E N D O S I:**

1. Të pezullojë zhvillimin e procedurave të shortit për muajin maj, korrik, shtator 2019.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**

**Genta Tafa (Bungo)**

